



AIDA

Albanian Investment Development Agency
Agencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

SEKTORI I BIMËVE MJEKËSORE AROMATIKE



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001



HISTORIKU I SEKTORIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

STATISTIKA TË VITEVE TË FUNDIT

PESHA NË EKSPORT

RRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT

PROCESET E PUNËS, PRODUKTET DHE SHËRBIMET

TEKNOLOGJIA DHE INOVACIONI

STANDARDET DHE CERTIFIKIMI

AVANTAZHET E SEKTORIT

EKSPORTUESIT MË TË MËDHENJ

HISTORI SUKSESI

MBËSHTETJA E SEKTORIT NGA SHTETI DHE AIDA

HISTORIKU I SEKTORIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

Në vendin tonë ekziston një traditë që në kohët e hershme për grumbullimin dhe përpunimin e bimëve aromatike e mjekësore sidomos në rrethet: Malësi e Madhe, Kukës, Dibër, Elbasan, Berat, Skrapar, Përmet dhe Gjirokastrë. Bimët aromatike dhe mjekësore në Shqipëri dallohen jo vetëm nga një variacion relativisht i gjerë i formave dhe llojeve, por edhe për përmbajtjen e lartë të lëndëve aromatizuese dhe farmakologjike.

Deri në vitin 1990, eksportoreshin rreth 50-60 mijë ton, duke shfrytëzuar rreth 165 specie mjekësore dhe aromatike, taninë dhe esenca të florës spontane dhe të kultivuara. Thuajse në çdo rreth u krijuan ndërmarrjet e grumbullim-përpunimit dhe ndërmarrjet pyjore si dhe disa ndërmarrje përpunimi ku ishin instaluar distilatorë për distilimin e bimëve mjekësore. Rrjeti i furnizimit në periudhën para viteve 90' ishte i organizuar përmes kompanisë së vetme shtetërore Albanian Import Export (AlbImpEx), administruar nga qeveria, e cila kryente lidhjet mes tregjeve botërore për shitjen e bimëve mjekësore dhe erëzave. Gjatë kësaj periudhe vlera e eksporteve shkonte rreth 60-70 milionë USD në vit dhe Shqipëria ka qenë një nga eksportuesit më të mëdhenj të bimëve etero-vajore dhe mjekësore të egra në Evropë.



STATISTIKA TË VITEVE TË FUNDIT

Sektori i BMA-ve, ka një potencial të madh zhvillimi, gjeneron punësim të qëndrueshëm dhe është burim ekonomik për shumë familje në zonat rurale të vendit.

Në këtë sektor angazhohen rreth:

- **85** mijë persona, (grumbullues, fermerë, përpunues, eksportues, të punësuar kryesisht në zonat rurale),
- **31** kompani përpunuese eksportuese në shkallë vendi, prej të cilave 15 janë eksportues të mëdhenj,
- **150** grumbullues lokalë në shkallë vendi, prej të cilëve 10 grumbullues rajonalë,
- Më shumë se **400** specie janë identifikuar si bimë mjekësore aromatike të florës shqiptare, nga të cilat më shumë se 200 specie mbledhen dhe tregtohen,
- Reth **1/5** e familjeve rurale në zonat malore janë përfshirë në veprimtari që sjellin të ardhura nga bimët mjekësore aromatike, në mbledhje e kultivim, ose veprimtari të tjera në zinxhirin e vlerës së BMA-ve,
- **500** hektarë sipërfaqe të kultivuar me bimë mjekësore dhe aromatike.



Për sa i përket shtrirjes gjeografike, qarku i Shkodrës renditet i pari për pjesën që zenë BMA-të në të ardhurat e fermave familjare, i ndjekur nga Kukësi dhe Kolonja.

Tabelat e mëposhtme (1 dhe 2) pasqyrojnë të dhënat në nivel rrethi për numrin e fermerëve të përfshirë në veprimtaritë e BMA-ve dhe prodhimin e BMA-ve në ton për periudhën 2014-2019.

Rrethi	Nr. i fermerëve (në %)
Malësi e Madhe	90%
Kukës	48,6%
Kolonjë	41,4%
Librazhd	38,8%

Tabela 1: Numri i fermerëve të përfshirë në veprimtaritë e BMA-ve sipas rretheve kryesore

Prodhimi në Ton	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Bimë Medicinale	17.4	10.8	10.6	12.8	12.5	12.9	14.9

Tabela 2: Prodhimi (në ton) i Bimëve Medicinale 2014 - 2019 ¹

PESHA NË EKSPORT


- Rreth 95% e prodhimit të bimëve mjekësore aromatike eksportohet duke përfaqësuar gati 20% të totalit të eksporteve bujqësore të Shqipërisë.
- 70% e eksporteve të bimëve mjekësore shkon drejt Eurozonës, ndërsa pjesa tjetër, drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- Në vitin 2020, eksportet e bimëve mjekësore arritën mbi 5.7 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 16,4%.
- Reth 14.9 mijë ton bimë mjekësore u prodhuan në vitin 2020.
- Sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike gjeneron rreth 46 milionë euro nga eksporti, i listuar si sektori i dytë më i madh në eksportin bujqësor.
- Shqipëria bën pjesë në grupin e 25 eksportuesve kryesorë të BMA-ve në botë.
- Destinacioni kryesor i eksporteve është Gjermania, Franca dhe SHBA.

Tabelat e mëposhtme (1 dhe 2) tregojnë, rritjen në vlerë dhe në peshë (kg), të eksporteve të farave vajore dhe bimëve industriale ose medicinale gjatë periudhës 2016 - 2020.

Tabela 1: Eksportet në vlerë të farave vajore dhe bimëve industriale ose medicinale 2016-2020 ²



Tabela 2: Eksportet në peshë (kg) të farave vajore dhe bimëve industriale ose medicinale 2016-2020 ³



1 INSTAT
2 INSTAT
3 INSTAT

RRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT



Shqipëria, vitet e fundit është renditur ndër vendet e para në Europë për eksportin e bimëve mjekësore aromatike. Pandemia e COVID-19, ka bërë që eksporti nga vendi ynë të shumfishohet duke ndikuar edhe në rritjen e të ardhurave nga ky sektor.

Sipas eksportuesve më të mëdhenj të Shqipërisë, shitja e bimëve mjekësore, veçanërisht sherebelës dhe boronicës në vendet e Europës dhe SHBA, ka pësuar rritje të konsiderueshme. Përdorimi më së shumti i çajrave me përmbajtje të vitaminës C në pandemi nxiti rritjen e kërkesës së tyre. Tregu ndërkombëtar ka një kërkesë të lartë për bimët e egra natyrale të Shqipërisë me vlera të jashtëzakonshme medicinale.

Rritja e eksporteve është e nxitur nga një kombinim i rritjes së ofertës (kryesisht nëpërmjet shtimit të sipërfaqes së kultivuar të BMA-ve) dhe rritjes së kërkesës në tregjet botërore. Pavarësisht shtimit të

sipërfaqeve të mbjella dhe shtimit të kulturave, kjo industri ende vuan mungesën e investimeve në përpunim.

Baza e prodhimit për këto bimë në Shqipëri, tradicionalisht është dominuar nga BMA-të e egra që mund të gjenden në të gjithë vendin. BMA-të e egra kanë reputacion si produkte të cilësisë së lartë gjë që përfaqëson asetin më të vyer të këtij sektori. Rreth 70% e sherebelës që hyn në SHBA, është e markës "Made in Albania".

Tregu vazhdon të ketë sfidë standardet e grumbullimit dhe paketimit të bimëve, për të cilat komuniteti i biznesit të këtij sektori po bën përpjekje, i mbështetur edhe nga grantet që jep qeveria, për të përmirësuar teknologjinë e grumbullimit dhe përpunimit të tyre duke zgjeruar kështu tregjet eksportuese.

Eksportet përbëhen kryesisht nga Bimët Mjekësore Aromatike të papërpunuara - vetëm një pjesë e vogël e tyre përpunohen në vajra esencialë (ose esenca etero-vajore). Mbetet potencial për investim prodhimi i detergjentëve, produkteve kozmetike ose barnave industriale me bazë Bimët Mjekësore Aromatike, fusha të cilat nuk janë eksploruar deri më tani.

Shqipëria ka një kapacitet mesatar eksportesh prej 12 mijë tonë bimë mjekësore aromatike, pavarësisht se kapaciteti real i prodhimit e kalon 120 mijë tonë bimë, sipas Shoqatës së Bimëve Mjekësore Aromatike (AMAP). Duke u bazuar në nivelin e eksporteve për vitin 2020, i cili e kaloi vlerën e 50 milionë dollarëve (muajin nëntor), pritet rritje e mëtejshme gjatë vitit 2021. Po sipas Shoqatës AMAP, kapacitetet përpunuese më të thella do të sillnin rritje dyshifrore të eksporteve të bimëve mjekësore aromatike. E ardhmja e tregut do të jetë kultivimi në fushë i farave të zgjedhura, për të cilat më parë është gjetur tregu.

PROCESET E PUNËS, PRODUKTET DHE SHËRBIMET

Kultivimi dhe mbledhja e bimëve medicinale dhe aromatike në Shqipëri ka një histori të gjatë, por edhe një potencial të madh për zhvillim dhe rritje.

Aktorët kryesorë në zinxhirin e vlerës së BMA-ve, janë vjelësit dhe kultivuesit e BMA-ve, grumbulluesit, konsoliduesit, të ndarë në dy nënkategori:

- Grumbullues në nivel rrethi ose qarku dhe grumbullues individualë;
- Përpunuesit dhe eksportuesit që mund të jenë të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj;
- Vjelësit dhe kultivuesit janë persona që jetojnë në zonat rurale dhe malore të vendit. Mbledhin BMA të egra, i thajnë dhe i ruajnë në shtëpitë e tyre derisa i shesin te një grumbullues ose përpunues;
- Grumbulluesit në nivel rrethi janë aktorë të ndërmjetëm mes fermerëve dhe përpunuesve. Megjithatë ata nuk kanë linja të mirëfillta përpunimi, ata kryejnë disa procese të thjeshta që mund të konsiderohen si përpunimi i parë, duke përfshirë tharjen, pastrimin, etj.;
- Përpunuesit e vegjël kryejnë një përpunim të thjeshtë, zakonisht, produkti thjesht pastrohet, grihet dhe paketohet në thasë;
- Eksportuesit përpunojnë dhe tregtojnë një gamë të gjerë llojesh të BMA-ve; disa eksportues përpunojnë e eksportojnë/shesin më shumë se 100 lloje të BMA-ve. Produktet kryesorë janë BMA-të e thara, të grira e të ambalazuara;
- Disa përpunues - jo vetëm të mëdhenj - prodhojnë edhe vajra esenciale si nënprodukt të produkteve kryesore që janë BMA-të e thara.

Proceset e përfshira në këtë sektor si grumbullimi, prodhimi, përpunimi, magazinimi, paketimi dhe të tjera, gjenerojnë rritje të vendeve të punës, si dhe zgjidhje alternative ekonomike për Shqipërinë në zonat rurale.

PRODUKTET MË TË EKPORTUARA

Ndër bimët aromatiko-mjekësore që kanë një peshë të madhe në prodhimin kombëtar dhe në eksport konsiderohen; sherebela (*Salvia officinalis* L.), rigoni i bardhë (*Origanum vulgare* ssp. *hirtum* L), trumza e maleve (*Satureja montana* L.), Kalendula (*Calendula officinalis*), dëllenja e zezë (*Juniperus communis* L.), mërsina (*Myrtus communis* L.), lulebasani (*Hypericum perforatum* L.), molla e egër (*Malus sylvestris* Miller), trëndafili i egër (*Rosa canina* L.) dhe murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna* Jac).



TEKNOLOGJIA DHE INOVACIONI

Industria e bimëve aromatike dhe mjekësore ka potencial për të përmirësuar më tej performancën për sa i takon sasisë dhe vlerës së eksporteve. Investimet në praktikën e pas tharjes përmes pajisjeve të tharjes dhe ato të paketimit mund të luajnë një rol vendimtar në rritjen e të ardhurave për të gjithë aktorët në këtë industri dhe më shumë vende pune për banorët e zonave rurale.

Në këtë sektor nevojiten dhe priten gjithashtu investime të rëndësishme në prodhimin e vajrave esenciale ose rafinimin e tyre. Gjithsesi, të bëhesh pjesë e tregut të vajrave esenciale me cilësi të lartë është një sfidë për shkak të kërkesave teknologjike dhe politikave të kompanive të huaja importuese, prandaj kërkohen ndërhyrje si në përmirësimin e teknologjisë, ashtu edhe në përmirësimin e aksesit në treg - duke identifikuar tregun dhe duke negociuar për aksesin në këtë treg.

STANDEDET DHE CERTIFIKIMI

Certifikimi organik është bërë i pranishëm në Shqipëri në mes të viteve 1990, për shkak të rritjes së kërkesës për bimët mjekësore dhe aromatike (BMA). Disa eksportues të BMA-ve në Shqipëri janë të pajisur me certifikata organike sipas kërkesave të tregut të BE-së dhe SHBA-ve. Certifikimi organik i BMA-ve përbën një potencial jo vetëm për tregjet e eksportit (ku janë kanalizuar shumica e BMA-ve), por edhe për tregun e brendshëm në rritje.

Shumica e produkteve të ndërmarrjeve janë të certifikuara sipas Standardit Organik Evropian 834/07 dhe Standardit Organik të SHBA NOP.

Shqipëria është furnizuese e rëndësishme e BMA-ve në formën e lëndës së parë apo pjesërisht të përpunuar për shumë industri të BE-së dhe SHBA-ve, në sektorë të ndryshëm, (industria e ushqimit dhe pijeve, barnave, kozmetikës dhe parfumeve, aditivëve në ushqim etj.). Plotësimi i standardeve të produkteve të eksportuara (standartet e sigurisë, standardizimi i nivelit të lagështisë, përzjerja e varieteteve me vlera të ndryshme etj), ka qenë dhe është një sfidë për konkurrueshmërinë në eksporte.



AVANTAZHET E SEKTORIT

- Përvoja e gjatë dhe ekspertiza në grumbullimin, kultivimin dhe tregtimin e BMA-ve.
- Toka dhe kushtet klimatike të përshtatshme për zhvillimin e sektorit të BMA-ve.
- Reputacion i mirë lidhur me cilësinë e lartë të BMA-ve shqiptare të egra.

Disponueshmëria e krahut të punës për vjelje dhe kultivime të BMA-ve.

Investimet e bëra në mjediset bashkëkohore të tharjes.

Përpjekjet për të shfrytëzuar tregun e brendshëm për bimët mjekësore, barnat dhe erëzat; disa investime në prodhimin e çajit.

Konsolidimi i eksportuesve të mëdhenj dhe shtimi i investimeve nga ana e tyre.

Kërkesa e vazhdueshme ndërkombëtare për BMA të egra dhe të kultivuara.

Sipërfaqet e mëdha të disponueshme për kultivimin e BMA-ve.

EKSPORTUESIT MË TË MËDHENJ

Ndër kompanitë eksportuese më të mëdha të këtij sektori në Shqipëri, sipas të dhënave të vitit 2020, renditen:

- | | |
|-----------------------------|---------------------|
| 1. Filipi Co Herbs & Spices | 6. Albania Herb SHA |
| 2. Albkalustyan | 7. CIBUKU |
| 3. Herba Fructus Natyror | 8. RELIKAJ |
| 4. Agroherbal | 9. MEIA |
| 5. Gjendra Berat | |

HISTORI SUKSESI

Filipi Co herbs & spices është një kompani e themeluar në Laç, më 25 korrik 1991, e specializuar në mbledhjen, përpunimin e bimëve medicinale dhe aromatike. Fillimisht kompania e ka nisur aktivitetin si një kompani e specializuar në tregtimin e sherebelës dhe trumzës por me ritme të shpejta u zgjerua gama e produkteve të tregtuara në aspektin e shumëllojshmërisë dhe atë të shkallës së përpunimit. Në vitin 1993 kompania nënshkroi kontratën e parë me firmën Amerikane "AA Sayia" dhe sot kanë arritur të vendosin marrëdhënie me më shumë se 70 kompani në Europë, Amerikë dhe Australi. Sot, pas 30 vitesh aktivitet në grumbullimin, përpunimin dhe eksportimin e bimëve mjekësore mban vendin si kompania më e madhe në Ballkan.

Gjedra Ltd, ka filluar aktivitetin në mbledhjen dhe procesimin e bimëve medicinale në vitin 1993, e lokalizuar në qytetin e Beratit. Ajo është një nga eksportuesit kryesor të bimëve medicinale në Shqipëri. Gjendra eksporton produktet si: lule, gjethe, herba, rrënje, lëvore, fruta, vajra esencialë. Ajo eksporton në SHBA, Gjermani, Itali, Spanjë, Maqedoni, Bullgari, Hungari, Greqi etj. Gjendra bashkëpunon me rreth 3500 fermerë, në grumbullimin e bimëve medicinale dhe tregtimin e tyre.

Herba Fructus Natyrore sh.p.k, e lokalizuar në qendër të Shqipërisë, në qytetin e Elbasanit, operon në tregun e bimëve (bimë medicinale dhe aromatike të thata) dhe erëza, që nga viti 1992, me përvojë menaxhimi prej më shumë se 50 vitesh dhe qëndrueshmëri, e cila nga një kompani e vjetër shtetërore e bimëve dhe erëzave, tashmë është e rinovuar plotësisht. Tregu i tyre shtrihet mbi 70% e eksportit në Europën Perëndimore, në vende si Gjermania, Italia, Franca, Spanja, Zvicra, Greqia dhe 30% në SHBA. Kompania ka një staf fiks prej 120 punëtorësh ku shitjet vjetore shkojnë midis 3.500.000 Euro – 4.500.000 Euro për 5 vitet e fundit.

MBËSHTETJA E SEKTORIT NGA SHTETI DHE AIDA

Shërbimet e AIDA-s në ndihmë të NVM-ve shqiptare

AIDA ofron shërbime për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, ndërtim kapacitetesh, informacion mbi tregjet, doganat, mbështetje për promovim, nëpërmjet panaireve, misioneve të biznesit, kërkime tregu dhe publikime të përgjithshme sektoriale, si: anketime, informacion online mbi tregjet e eksportit, databazë importuesish dhe eksportuesish etj.

AIDA, për t'u ardhur në ndihmë kompanive shqiptare në sektorin e Bimëve Mjekësore Aromatike, nëpërmjet fondeve të Konkurrueshmërisë, Inovacionit dhe Start-up, gjatë periudhës 2014-2019, ka mbështetur rreth 20 kompani të sektorit të BMA-ve, për certifikime, ambalzhimin dhe etiketim të produkteve të tyre, pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, trajnime dhe takime B2B.

Në vitin 2020, AIDA ishte pjesëmarrëse në panairin më të madh ndërkombëtar të sektorit të Bimëve Medicinale dhe ushqimit organik "Biofach 2020", në Nurenberg, i mbajtur në datat 12-15 shkurt 2020. AIDA mbështeti 5 kompani shqiptare (Albanian Herb, Albfruit 2005, Bidaj, Bioalba Group, BioBes) të merrnin pjesë me standë të dedikuar në pavijonin e përbashkët të Shqipërisë. Përfaqësuesit e 5 kompanive shqiptare zhvilluan më shumë se 481 bisedime dhe takime bilaterale me partnerë të biznesit në Biofach 2020, për bashkëpunime të mundshme në rajon dhe BE. AIDA në këtë organizim bashkëpunoi me partnerët SIPPO dhe RISI Albania.



AIDA, nëpërmjet zbatimit të Rrjetit European të Ndërmarrjeve në Shqipëri (EEN-Albania), mundëson për biznesin shqiptar mbështetje, si:

- Marrëveshje ndërkombëtare (ekspertizë, kontakte, aktivitete për të lidhur kompanitë shqiptare me partnerë potencialë të huaj, për të rritur biznesin e tyre).
- Këshillim për rritje ndërkombëtare (këshillim nga ekspertët për rritje dhe zgjerim në tregjet ndërkombëtare).
- Inovacioni në biznes (shërbime të orientuara nga zgjidhja për të ndihmuar kompanitë të kthejnë idetë e tyre inovative në suksese tregtare ndërkombëtare).



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001

